



REPUBLIKA E SHqipërisë

MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE

KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

Nr. 109 Prot

Tiranë, më 26/08/ 2010

VENDIM Nr. 14 dt. 20.08.2010

Në mbështetje të nenit 17, pika 6, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, ndryshuar me ligjin nr. 9882, dt 28.02.2008, "Për Trashëgiminë Kulturore", Këshilli Kombëtar i Restaurimeve në mbledhjen e datës 20.08.2010,

VENDOSI:

I. Lidhur me: Diskutimi i projekteve të propozuara nga Bashkia Durrës

1. **Miratohet:** Projekt zbatimi për rivitalizimin urban të sheshit tek Busti i Azem Hajdarit dhe para godinës së Alb-Telekomit, Durrës, me kondicionin:
 - *Ndërhyrjet që do të bëhen në shesh të mbikëqyren nga një arkeolog i Agjensisë së Shërbimit Arkeologjik.*
 - *Busti i Azem Hajdarit, pas përfundimit të punimeve të rikthehet në vendndodhjen e mëparshme.*

II. Do të diskutohet në mbledhjen e rradhës së KKR:

1. Rivitalizimi i sheshit "ILIRIA", faza e I, (Shkallaret).

- Ngarkohet sekretaria teknike, për njoftimin e këtij vendimi.
- Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

FERDINAND XHAFERRAJ

SEKRETAR I KKR
AKADEMIK. APOLLON BAÇE